



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2015

SESIONI I

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

Varianti A

Lënda: Gjuhë shqipe dhe Letërsi

Profesionale, artistike, sportive, me kohë të shkurtuar

PJESA I

Reklamat

Pyetja 1	B	1 pikë
Pyetja 2	C	1 pikë
Pyetja 3	B	1 pikë
Pyetja 4	C	1 pikë
Pyetja 5	D	1 pikë
Pyetja 6	D	1 pikë
Pyetja 7	A	1 pikë

Pyetja 8 **2 pikë**

➤ **Karakteristikat:**

- Hyrja është e shkurtër, prezantohet çështja;
- Fillon me kundërtëzën dhe argumentet mbështetëse të saj (këndvështrimi I);
- Më pas ka argumente në mbështetje të tezës;
- Çdo argument kundra tezës shoqërohet me një argument pro asaj;
- Në paragrafin përmbyllës shfaqet qëndrimi i autorit, por njëkohësisht diskutimi lihet i hapur;
- Koherenca dhe kohezioni sigurohen përmes përshtatjes morfologjike të fjalëve, përmes përdorimit të një gjuhe të saktë, përmes mjeteve lidhëse (lidhëza, përemra lidhorë, ndajfolje etj.).

2 pikë Nëse gjen dy karakteristika të strukturës së tekstit.

OSE

1 pikë Nëse gjen vetëm një karakteristike.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 9 **3 pikë**

➤ **Teza:** Reklama është katalizatori në procesin e shitjes dhe të blerjes.

- **Argumenti 1:** Pa reklamën, televizionet dhe revistat do të falimentonin, pasi reklamat kontribuojnë në një pjesë të madhe të të ardhurave të tyre.
- **Argumenti 2:** Kërkoni po të doni, por kurrë nuk do të gjeni në regjistrat e gjyqeve një rast të vetëm të një qytetari të pafajshëm, që është detyruar nga reklamuesit apo reklamat të blejë diçka që ai ose ajo nuk e ka dashur.
- Etj.

1 pikë Nëse gjen tezën.

DHE

2 pikë Nëse identifikon dy argumente në mbështetje të tezës.

OSE

1 pikë Nëse identifikon vetëm një argument në mbështetje të tezës.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Në përgjigjen e dhënë, nxënësi mund t'i marrë argumentet si fjali të gatshme nga teksti ose t'i perifranojë.

Pyetja 10 **3 pikë**

➤ **Kundërteza:** Reklamën të kritikohen me idenë se ato zhvatin konsumatorin dhe ndotin zonën të tërë me grumbuj hedhurinash.

➤ **Pasojat:**

- dëmtojnë mendjet e fëmijëve dhe të rinjve;
- po përshpejtojnë zhdukjen e materialeve të rralla nga planeti;
- njerëzit blejnë gjëra që realisht nuk iu duhen.

1 pikë Nëse gjejnë kundërtezën.

2 pikë Nëse identifikojnë dy pasoja negative.

OSE

1 pikë Nëse identifikon vetëm një pasojë negative.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 11 **2 pikë**

➤ **Teknikat:**

- përdorimi i vetës II shumës, duke iu drejtuar dretpërdrejt lexuesit/dëgjuesit;
- mbyllja mbetet e hapur, fton lexuesin të shtojë gjykimin e tij;
- përdorimi herë pas here i një leksiku të shkujdesur, bisedor;
- toni sugjerues.

1 pikë Nëse identifikon dy teknika.

1 pikë Nëse identifikon vetëm një teknikë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 12 (a) 2 pikë

- **Shprehja** “mekanizëm i shpëlarjes së trurit” nënkupton që dikush nuk mendon më dot sipas mënyrës së vet; atij i imponohen mendime dhe gjykime të tjera.
- **Qëndrimi i autorit:** Autori nuk e pranon mendimin se qytetari është i pafuqishëm përballë fuqisë së reklamave. Këtë mendim e mbështet kur thotë se *kurrë nuk do të gjeni në regjistrat e gjyqeve një rast të vetëm të një qytetari të pafajshëm, që është detyruar nga reklamuesit apo reklamat, të blejë diçka që ai ose ajo nuk e ka dashur.*

1 pikë Nëse shpjegon domethënien e shprehjes së dhënë.

1 pikë Nëse tregon qëndrimin e autorit në lidhje me fenomenin e dhënë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 12 (b) 2 pikë

➤ **Burimet:**

- statistika;
- lajme aktuale;
- mendime të konsumatorëve në lidhje me reklamat (intervista);
- grafikë të shitblerjeve.

2 pikë Nëse identifikon dy burime që do të përdorëshin për të shkruar një artikull kërkimor.

OSE

1 pikë Nëse identifikon vetëm një burim.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

PJESA II

Hygo

Katedralja e Parisit

Pyetja 13	B	1 pikë
Pyetja 14	C	1 pikë
Pyetja 15	A	1 pikë
Pyetja 16	B	1 pikë
Pyetja 17	C	1 pikë
Pyetja 18	B	1 pikë

Pyetja 19 **2 pikë**

- **Raporti:** Kuazimodoja e sheh katedralen si shtëpinë e tij, strehën e tij, qetësinë e tij.
- **Arsyeja:** Aty ndihet i sigurt, i qetë, i patrazuar nga të tjerët.

OSE

- **Raporti:** Kuazimodoja e shikon katedralen si vendin e sigurt, ku mund të jetojë i qetë, pa u trazuar prej askujt.
- **Arsyeja:** për shkak të raportit që ka me shoqërinë.

1 pikë Nëse tregon raportin që Kuazimodoja ka me katedralen.

DHE

1 pikë Nëse tregon arsyen e këtij raporti.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 20 **2 pikë**

➤ **Arsyet:**

- prejardhja e panjohur;
- shëmtimi fizik.

2 pikë Nëse identifikon dy arsytet e veçimit në fillim të Kuazimodos.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 21 **2 pikë**

- **Ndjesia:** trishtim.
- **Arsyeja:** Kuazimodos iu mbyll e vetmja mundësi komunikimi me botën.

1 pikë Nëse identifikon ndjesinë.

DHE

1 pikë Nëse tregon arsyen e kësaj ndjesie.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 22 **3 pikë**

- **Qëndrimi:** Shoqëria e përbuz, e injoron, e urren, e përqesh, e mallkon, e poshtëron Kuazimodon.

Argumentim i plotë:

- **Përshtypja:** Në këtë qëndrim të bën përshtypje mënyra se si **grykohet** Kuazimodoja dhe se si turma **sillet** me të. Njerëzit grykohen mbi bazën e pamjes dhe të prejardhjes. Kuazimodoja është i vetmuar, i përqeshur, i tallur, sepse është ndryshe nga të tjerët ose të paktën, ata e grykojnë si të tillë. Turma nuk i duron dot ata që janë ndryshe dhe nuk përputhen me normat që ka krijuar.

Argumentim i pjesshëm:

- Në këtë qëndrim të bën përshtypje se si turma sillet me Kuazimodon.

OSE

- Të bën përshtypje urrejtja, përbuzja e njerëzve ndaj Kuazimodos.

1 pikë Nëse konstaton qëndrimin e shoqërisë ndaj Kuazimodos.

DHE

2 pikë Nëse nxënësi argumenton në mënyrë **të plotë** se çfarë i bën përshtypje në këtë qëndrim.

1 pikë Nëse nxënësi argumenton në mënyrë **të pjesshme** se çfarë i bën përshtypje në këtë qëndrim.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 23 **3 pikë**

- Të dy fjalitë mbështeten mbi metafora. Në nëntekst kuptojmë se të dëgjuarit, që kishte qenë e vetmja derë e komunikimit me botën, tashmë ishte mbyllur. Pra, Kuazimodos iu mbyll çdo mundësi komunikimi me botën jashtë mureve të katedrales. Ai u krodh (zhyt) në errësirën e vetmisë dhe të izolimit.

Figurat:

- metaforë: kjo derë ndali, rreze gëzimi dhe drite (komunikimi), depërtonte në shpirtin; shpirti u krodh në errësirë.
- epitet: e thellë

2 pikë Nëse zbërthen në mënyrë të plotë nëntekstin e fjalive të dhëna.

1 pikë Nëse zbërthen në mënyrë të pjesshme nëntekstin e fjalive të dhëna.

DHE

1 pikë Nëse interpretimin e dhënë e bazon në figuracionin që fjalitë mbartin.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 24 **3 pikë**

➤ **Qëndrimi i autorit në dy momente:**

- Në momentin e parë qëndrimi i autorit vjen në formën e keqardhjes, mëshirës ndaj Kuazimodos. Gjymtimi fizik i personazhit që ka ardhur si pasojë e shkaqeve natyrore (nga lindja apo kambanat), sjell edhe gjymtimin e tij mendor. Pikërisht, këtu autori shfaq keqardhjen e tij. Kjo duket përmes përzgjedhjes së shprehjeve apo të fjalëve me ngarkesa emocionale: *fatzi, fatkeqësi, fëmijë i gjetur, i mjerë* etj.
- Momenti tjetër i qëndrimit të autorit shfaqet në formën e justifikimit të ligësisë së Kuazimodos (pra, në një mënyrë ai e merr atë në mbrojtje): është shoqëria shkaktare e kësaj ligësie.

Ilustrime: *ne duhet të tregohemi të drejtë dhe të themi se, ndoshta, ligësia e tij nuk ishte diçka e lindur së bashku me të.*

2 pikë Nëse analizon në mënyrë të plotë qëndrimin e autorit që shfaqet në dy forma në momentet përkatëse.

DHE

1 pikë Nëse përdor ilustrimet duhura.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 25 **8 pikë**

Për esenë do të ndiqen kriteret e mëposhtme:

KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan një ese, ku argumenton nëse është dakord ose jo me pohimin e dhënë;
- mban qartë një pozicion të dukshëm në zgjedhjen e bërë;
- përdor shembuj dhe arsye specifike për të mbështetur përgjigjen e dhënë, duke iu referuar përvojës personale ose edhe përvojave të të tjerëve;
- ka qartësi mendimi.

KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË **2 pikë**

1 pikë **Struktura e esesë**

- respekton elementet e strukturës së esesë:
 - hyrjen;
 - zhvillimin;
 - përfundimin.

Nxënësi merr **1 pikë**, nëse përgjigjen e dhënë e strukturon sipas skemës së mësipërme.

1 pikë **Organizimi i esesë**

- organizim logjik, ku shfrytëzohen teknika të tilla, si: koherenca dhe unifikimi i paragrafëve (lidhja logjike mes paragrafëve, kalimi në mënyrë të natyrshme nga njëri paragraf te tjetri).

KRITERI III: STILI DHE ORIGJINALITETI **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor, krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë;
- shprehet me një gjuhë eseistike;
- ka fjalor të pasur;
- ka stil origjinal.

KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE **2 pikë**

(1 pikë sintaksa dhe 1 pikë drejtshkrimi)

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore;
- ndërton fjali të sakta dhe të qarta;
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm;
- ka saktësi drejtshkrimore.